



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1013/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Eleonora Isufi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga e Eleonora Isufi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj me shenjën ZL.Anr.1013/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.1013/2017 me datën 10.11.2017, nga parashtruesja e apelit Eleonora Isufi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, e cila pretendon se ka pasur shumë parregullsi, dhe numërimi i votave nuk ka qenë real në këto vendvotime si: 2502x/05R, 2502x/06R, 2502x/07R, 2501D/01R, 2501D/02R, 2501D/03R, 2501D/05R, 2507D/01R, 2507D/02R, 2507D/05R, 2507D/06R, 2506D/02R, 2506D/03R, 2515D/01, 2515D/02, 2516D/01D, 2515/03, 2520D/01D, 2523D/2R, 2523D/03R, 2515D/02R, 2533D/02, 2510D/03, 2510D/04, 2510D/05, 2518D, 2511D.

Kërkon nga PZAP-i që ti rinumëroj votat e saj.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të apeluesit gjeti se apeli është i pabazuar sepse nuk është specifikuar saktë dhe me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet e lartëcekura. Prandaj Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si i tillë apeli u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.1013/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuese e Panelit
Gylten Sylejmani



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*